

ETIKA NË LIDHJE ME USHTRIMIN DHE MBAJTJEN E MANDATIT TË DEPUTETIT.	3
VËSHTRIM KRAHASUES	3
Kodet Etike si forma të disiplinimit të sjelljes së deputetëve	3
Elementët themelorë të një kodi sjelljeje	5
Parime të përgjithshme të Kodeve te sjelljes	5
Rregullat dhe instrumentet e deklarimit dhe transparencës së interesave	9
ANALIZË E LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQPËRISË NË LIDHJE ME ETIKËN DHE KODIN E SJELLJES SË DEPUTETIT	11
Liria e shprehjes	11
Rregullorja e Kuvendit.	11
Kodi i Proçedurave Adminsitrative.	12
Ligji “Për Statusin e Deputetit”	12
Ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”	13
Ligji “Për parandalimin e konfliktit të intëresave në ushtrimin e funksioneve publike”	16

ETIKA NË LIDHJE ME USHTRIMIN DHE MBAJTJEN E MANDATIT TË DEPUTETIT.

VËSHTRIM KRAHASUES

Deputetët konsiderohen si përfaqësuesit e drejtëpërdrejtë të interesave të zgjedhësve të tyre. Tashmë, çështja e ruajtjes së standarteve të larta të sjelljes në publik, është kthyer në njëçështje me rëndësi thelbësore për pasjen dhe ruajtjen e vlerave demokratike. Disiplinimi i aspekteve të ndryshme të sjelljes parlamentare mund të bëhet nëpërmjet:

- a) Kodeve të sjelljes, të cilat përbëjnë tërësinë e rregullave ekzistuese mbi standartet etike parlamentare në një dokument të vetëm.
- b) Regjistrave për deklarimin e aseteve dhe interesave. Detyrimi për deklarimin e aseteve dhe interesave rrjedh nga fakti se gjatë veprimtarisë parlamentare deputetët duhet të zgjedhin mes detyrimeve të rolit të tyre profesional dhe interesit personal nga ana tjetër. Deputetëve u lejohen të kenë interesa apo asete të caktuara, por ato detyrohen t'ia bëjnë transparente publikut. Megjithatë çështja e privatësisë është një aspekt që duhet trajtuar me kujdes.
- c) Rregullat mbi dietat dhe shpenzimet. Deputetët kanë nevojë për burime të mjaftueshme në mënyrë që ti kryejnë me efikasitet detyrat e tyre. Për këtë arsye ata kanë nevojë për dieta nga shteti për mbulimin e kostos së zyrave përkatëse, udhëtimeve apo shpenzimeve të tjera. Shpenzimi i parave publike duhet të bëhet vetëm për realizimin e funksioneve publike.

Kodet Etike si forma të disiplinimit të sjelljes së deputetëve

Së pari duhet të theksojmë se mandati i deputetit, është një mandat përgjegjësie, pasi deputetet përfaqësojnë zona zgjedhore të ndryshme të cilat mbartin njerez dhe problematika specifike. *Si e tillë kjo marrëdhënie "përgjegjësie" rregullohet me anën e disa standarteve të cilat përbëjnë Kodin Etik të Deputetit. Këto standarte etike në shumë parlamente janë të materializuara në dokumenta formalë, ndërsa në disa të tjera jo.* Si shembuj të rregullimit të sjelljes së deputetëve me anën e kodeve të sjelljes mund të merren dy nga demokracitë më të zhvilluara, ajo e SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në SHBA, Kodi i Sjelljes Zyrtarë i udhëzon anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve në mënyrë të tillë që të rrisin besueshmërinë e dhomës. Kodi është më i hollësishtëm se kodet e tjera të hulumtuara dhe përmban ndalime për *dhuratat, përplasjen e interesave,*

Lecture notes prepared by E. Olldashi

përzierjen e fondeve vetjake me fondet e fushatës, keqpërdorim të burimeve zyrtare. Kodi i Sjelljes për anëtarët e Dhomës së Komunave (dhoma e ulët) në Britaninë e Madhe përfshin ndalime mbi rryfshetin, avokatinë me pagesë, keqpërdorimin e informacionit.

Gjithsesi vështrimi i cili fton për një identifikim të qartë të asaj *cka duhet dhe nuk duhet*, të mbledhur në një paketë të plotë rregullash, me sanksione në raste shkeljesh, duket që po fiton terren, sepse shihet si një mënyrë për rritjen e integritetit të sektorit publik si dhe rritje e besimit të publikut në legjislativ. “Kodifikimi i sjelljes” së deputetëve ndikon në: përfitimin e shoqërisë në përgjithësi duke forcuar shtetin ligjor; marrëdhëniet midis parlamentarëve dhe elektoratit; marrëdhëniet midis parlamentarëve.

Kodet e sjelljes përmbajnë rregulla të kodifikuara, në mënyrë që të vihet një balance mes pragmatizmit politik dhe ekonomik me parimet e përfaqësimit demokratik dhe përgjegjshmërinë publike. Kodet e Sjelljes nuk përbëjnë vetëm mjete kontrolli për deputetët, por sjellin avantazhe të shumta për të zgjedhurin dhe zgjedhësve.

Nevojshmëria e një Kodi Sjellje lidhet me : **a)** Forcimi i shtetit ligjor- nëpërmjet kodeve të sjelljes synohet që të vendoset një kuadër rregullator i detyrueshëm mbi veprimtrainë e deputetëve duke ndikuar drejtëpërdrejtë në pavarësinë e parlamentit si organ përfaqësues; **b)** Besushmërinë e zgjedhësve - nëpërmjet Kodeve të Sjelljes qytetarit i jepet siguri dhe i përcaktohet masa me anën e së cilës ato vlerësojnë performancën legjislative; **c)** Kolegjialiteti- paketa e një sërë rregullash etike të kodifikuara i shërben parlamentarëve pavarësisht nga përkatësia partiake, në mënyrë që mes tyre të mbizotërojë një sens kolegjialiteti; **ç)** Avantazhe personale të të zgjedhurit- rregullat etike të kodifikuara sigurojnë një kornizë të qartë veprimi për deputetët duke forcuar kredibilitetin e tyre politik dhe në këtë mënyrë edhe shanset për tu rizgjedhur, në rast zbatimi korrekt; **d)** Të pranuarit e “lojës sipas rregullave”- kodifikimi i parimeve etike në rregulla të forta ligjore lehtëson vendimarrjen e deputetit në respekt të ligjit dhe të mirëqënies së publikut. Në të kundërt, moskodifikimi mund të lejojë hapësira për të bërë zgjedhje personale në lidhje me zbatimin ose jo të një rregulli si dhe mund të lejojë hapësira për interpretime subjektive të përmbajtjes së një norme të veçantë; **e)** Ofrimi i mënyrave të vlerësimit, kontrollit dhe vendosjes eventuale të sanksioneve nëpërmjet gjykatave apo mekanizmave të tjerë demokratikë- kodifikimi i rregullave të sjellejes duket sikur bie ndesh me pragmatizmin politik dhe ekonomik, i cili promovon se për të arritur përfundimet e dëshiruara politike çdo mënyrë është e pranueshme. Këto kode parashikojnë pasojat konkrete që do të rezultojnë në rast moszbatimi të detyrimeve nga ana e deputetit. Gjithashtu ato përcaktojnë edhe organet kompetente të cilave do tu adresohen raste të tilla si dhe llojin e zgjidhjes që ato ofrojnë.

Elementët themelorë të një kodi sjelljeje

Zakonisht rregullat mbi përgjegjshmërinë dhe etikën e deputetëve gjenden në kushteutat e vendeve të ndryshme si dhe në legjislacionin e posaçëm ku vihet re legjislacioni që rregullon deklarimin e interesave të deputetëve, ashtu edhe ai që parashikon konfliktet e mundshme të interesit së tyre privat me kryerjen e detyrave me karakter publik. Ky legjislacion gjendet i pranishëm në shumicën e vendeve të Europës Qëndrore e Juglindore e në rajon.

Kodi i sjelljes shkon edhe më tej duke vendosur standarte mbi çështje që nuk preken nga legjislacioni si: a) *mosdhenia llogari ose mospërgjegjia* ndaj institucioneve përgjegjëse për kontrollin e interesave të tyre; b) *keqpërdorim i privilegjeve që gëzon si deputet*; c) *keqpërdorim i përfitimeve dhe burimeve parlamentare*; ç) *përdorimi i pozicionit për avantazhe parlamentare apo personale*; d) *punësime të mëpasshme (mbas mbarimit të mandatit të deputetit)*; e) *kyerja e veprimeve që parandalojnë veprimtarinë e Kuvendit*.

Shume Kode Sjelljeje përqëndrohen në sjelljen me karakter financiar, por nuk duhet të lihen mënjandë edhe çështje që lidhen me fushën e moralit dhe integritetit si: a) Detyrimi i deputetit për të komunikuar në fushate zgjedhore dhe pas fushate- me marrjen e mandatit, nuk mbaron detyrimi që deputeti ka me zgjedhësit. Deputeti duhet të vazhdojë të mbajë kontakte me zgjedhësit, sidomos me vullnetarët e angazhuar në fushatë; b) Takime të lira, periodike me zgjedhësit pranë qendros mjedisi si dhe takime pranë Zyrës së Deputetit e cila duhet të ketë karakter solemn; d) Njohja e problemeve të zonës.

Parime të përgjithshme të Kodeve të sjelljes

Shqetësimet e opinionit publik, në përgjithësi lidhen me çështje që kanë të bëjnë me aspektin financiar dhe konfliktin e interesit; shkallën e pjesëmarrjes në seancat parlamentare dhe mbledhjet e komisioneve; përdorimin e informacionit të privilegjuar dhe përdorimin e fondeve parlamentare.

Ka disa parime të përbashkëta ku bazohen Kodet e Sjelljes për një sërë vendesh si:

1. **Pavarësia** - deputetët nuk duhet të kenë lidhje me organizata apo individë që mund të ndikojnë në aktivitetet e tyre si individë.
2. **Mosdikriminimi** - pavarësisht linjës politike, ideologjisë së partisë që ata mbajnë, deputetët nuk duhet të jenë diskriminues.
3. **Transparenca** - siguron llogaridhënie më të lartë ndaj publikut (elektoral, grupet e interesit apo edhe grupet mbështetëse) duke qartësuar interesat personale financiare dhe jo financiare. Kjo nënkupton detyrimin e deputetit për të bërë transparencën para institucionit përkatës, si dhe të

Lecture notes prepared by E. Olldashi

drejtën e publikut për të patur akses mbi këtë informacion. *Gjykata Kushtetuese Gjermane përshkroi rëndësinë e transparencës për rritjen e besimit ndaj Parlamentit. Sipas kësaj gjykate demokracia parlamentare mbështetet mbi besimin e njërëzve; besimi pa transparencën është i pamundur. Votuesi duhet të dijë se kë zgjedh. Kjo njohuri është shumë e rëndësishme jo vetëm për zgjedhjen e votuesit, por edhe për parlamentin gjerman duke i garantuar aftësinë aëtarëve të tij për të përfaqësuar njërëzt në tërësinë e tyre. Mbi të gjitha kjo njohje është e rëndësishme për vetë besimin në demokracinë parlamentare.*¹

4. **Rregullat kundër korrupsionit** - Anëtarët e Parlamentit kanë detyrime të ndryshme si p.sh., heqja dorë nga një veprim ose pozicion i papajtueshëm me detyrimet e deputetit; deklarimi i interesave finaciare dhe jo finaciare, para se të fillohet ushtrimi i mandatit të deputetit si dhe periodikisht kur kërkohet; promovimi i rregullave të transparencës lidhur me financimin e partive politike dhe fushatave elektorale; rregulla transparente në lidhje me lobimet
5. **Konflikti i interesit dhe deklarimi i interesave finaciare** - Duhet mënjanuar çdo konflikt mes detyrave me karakter publik dhe interesave privatë. Në rast të tilla konflikti, deputeti ose duhet të heqi dorë nga vendimarrja, ose duhet ta zgjidhë këtë përballje në interes të publikut. *Jo gjithmonë përballja e interesave nënkupton konflikt, sepse menaxhimi i drejtë i situatës, trasparenca dhe përgjegjësia në vendimarrje, do të sillte rezultate të kënaqshme.*

• Konflikti i interesave

Konflikti i interesave ndodh atëherë kur deputetët kanë interesa privatë të cilat “ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e përgjegjësisë”. Përgjithësisht përplasja ose konflikti i interesave është përkufizuar si një situatë në të cilën anëtarët e Parlamentit diskutojnë ose votojnë për çështje politike për të cilat ato kanë interes financiar.² Megjithatë duhet theksuar se përplasja mund të përfshijë edhe përfitime jo-finaciare.³

Duke marrë parasysh që deputeti duhet të jetë shembull i integritetit në komunitet, ai duhet të evitojë situatat e konfliktit të interesave. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë dy shkolla mendimi. Shkolla më strikte mban qëndrimin se kur deputeti përballon një konflikt midis detyrës së tij publike dhe interesave të tij private, në këtë rast ai duhet të tërhiqet ose të zgjidhë konfliktin në favor të pritshmërisë së publikut. Pozicioni më i butë është të pranosh që pozicioni midis interesit privat dhe interesit publik jo në mënyrë të domosdoshme çon në konflikt, nëse trajtohet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme. Deputetët duhet të jenë të hapur për interesat e tyre private si dhe duhet të justifikojnë çdo veprim që ndërmarrin.

¹ Shikoni pwr mw shumw “Standartet profesionale dhe Etike për Parlamentarët”, Studim Informativ, botuar nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

² Sipas Doracakut të Etikës të Dhomës së Kombeve të Bashkuara (1992), termi ka kuptim të kufizuar: ai tregon situatën kur përmbushja e detyrave nga ana e një zyrtari bie ndesh me çështjet ekonomike, private të tij.

³ “Code of Conduct for Parliamentarians” (Kod Sjelljeje për Parlamentarët), article

Lecture notes prepared by E. Oлдashi

Rregullimet e ndryshme kombëtare lidhur me këtë aspekt:

- Vendet që lejojnë votimin mbi çështjen që mund të përbëjë konflikt interesi - në Gjermani, Irlandë dhe Mbretërinë e Bashkuar, legjislatorëve u kërkohet të deklarojnë praninë e një përplasje të mundshme interesash, por u lejohej të votojnë çështjen.
- Vendet që nuk lejojnë votimin mbi çështjen që mund të përbëjë konflikt interesi apo përplasje interesash - në Australi, Kanada... etj.

Në lidhje më përplasjen ose konfliktin e interesave mund të klasifikojmë këto kufizime:

- *Kufizimet për punësimin jashtë parlamentit gjatë mandatit*

Shumë vende e kufizojnë punësimin e legjislatorëve jashtë parlamentit: në Hungari nuk mund të mbajnë ndonjë prej posteve të mëposhtme shtetërore: President i republikës, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, funksione të tjera të caktuara publike ose shtetërore, gjykatës ose anëtarë të forcave të armatosura të policisë ose të sigurisë; Franca, Italia dhe Koreja i shtrijnë më tej këto kufizime në poste gjysëm qeveritare, duke ndaluar caktimin e legjislatorëve në poste drejtuese në kompanitë shtetërore ose të ndihmuara nga shteti; Shumë vende vendosin kufizime të caktuara mbi punësimin në sektorin privat.

Kufizimet që vendosen për deputetët nuk do të thotë që ata nuk mund të mbajnë poste të tjera pune jashtë legjislaturës. Në të vërtetë shumica e legjislatorëve, janë të punësuar në sektorin privat ndërkohë që shërbejnë gjatë mandatit të tyre.

- *Kufizimet për punësimin pas mandatit*

Sjellja e padenjë e legjislatorëve mund të ndodhë edhe kur një parlamentar ose ministër largohet nga detyra. Problematika lind për shkak të faktit se deputetët gëzojnë qasje në informacionin e rezervuar dhe nëpërmjet lidhjeve qeveritare mund të ushtrojnë presion mbi ish kolegët e tyre. Disa vende për të parandaluar një fenomen të tillë e kufizojnë punësimin mbas mandatit: Franca e ndalon punësimin mbas mandatit në ndonjë korporatë në pronësi të qeverisë ose të subvencionuar nga qeveria si dhe në firmat e pasurive të patundshme ose bankat; Në Kore, deputetëve u ndalohet për 2 vjet të punojnë në korporata që kanë lidhje konkrete me legjislaturën; Anëtarëve të Kongresit Amerikan, u ndalohet të tentojnë të ndikojnë në Kongres, të komunikojnë me të, ose të dalin para tij për një vit pas largimit nga detyra. Kanadaja kufizon veprimtaritë e punësimit pas mandatit vetëm për ministrat.⁴

⁴Seria e Hulumtimeve Legjislative, "Etika Legjislative. Analizë Krahasuese", fq 30

Lecture notes prepared by E. Olldashi

- *Kufizimet për dhuratat*

Shumica e shteteve lejojnë marrjen e dhuratave nga ana e parlamenarëve pasi ato perceptohen si shprehje e respektit. Vende të ndryshme kanë zhvilluar metoda të ndryshme për rregullimin e kësaj praktike. Shumë vende lejojnë pranimin e dhuratave me kushtin që dhurata të cilat kalojnë një vlerë të caktuar, duhet të deklarohen: në SHBA ka kufizimet të rrepta për dhuratat- Kushtetuta u ndalon zyrtarëve federale të marrin dhurata nga qeveritë e huaja, ose përfaqësuesit e tyre- rregulli XXVI i Dhomës u ndalon anëtarëve dhe stafit të marrin të gjitha dhuratat që mund të përbëjnë përplasje interesi- dhuratat e tjera mund të pranohen përfshirë ngrënien në restorante, me kusht që me vlera të mos jetë më e madhe se 50 dollarë; në Gjermani duhet të deklarohen të gjitha dhuratat me vlerë mbi 5000 Euro, pavarësisht llojit të tyre; në Francë nuk ka kufizime në marrjen e dhuratave, por gjithsesi ato duhet të deklarohen- anëtarët e Asamblesë Kombëtare i kthejnë dhuratat përveç atyre të dhëna nga familjarët për të shmangur përshtypjen e shkeljes së rregullave; Koreja paraqet një rregullim të veçantë pasi përcaktohet një kufizim lidhur me dhuratat e ardhura nga një qeveri e huaj, organizatë e huaj ose vendase - këto dhurata që të jenë objekt i deklarimit duhet të kenë një vlerë më të madhe se 80 dollarë amerikanë.

- *Kufizimet për udhëtimet*

Pranimi i shpenzimeve të udhëtimit është një çështje për të cilën nuk ka një unifikim praktike nga ana e shteteve të ndryshme. Disa vende nuk vendosin kufizime lidhur me pranimin e shpenzimeve të udhëtimit, ndërkohë shumica e vendeve e trajtojnë udhëtimin si dhuratat dhe u kërkojnë legjislatorëve të *deklarojnë udhëtimet e sponsorizuara në deklarinë financiare të tyre*. Në Çeki bëhet dallimi mes udhëtimit të bërë për punë zyrtare dhe udhëtimit që nuk lidhet me pozicionin e punës; në SHBA, anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve mund të udhëtojnë por udhëtimi kufizohet në katër ditë, si dhe shtatë ditë për udhëtimet jashtë vendit. Shpenzimet e transportit dhe të pritjes që nuk lidhen aspak me detyrat zyrtare, të tilla si veprimtaritë për fushatat, fetare ose për punë jashtë mandatit, mund të pranohen. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit duhet të deklarohen. Shpenzimet e udhëtimit të paguara nga sipërmarrës të huaj kufizohen në shkëmbimet e ndërsjella kulturore; në Mbretërinë e Bashkuar, shpenzimet e anëtarëve ose të bashkëshortëve të tyre për vizitat jashtë vendit të cilat nuk janë krejtësisht të mbuluara nga anëtarët ose fondet publike, duhet të deklarohen. Shpenzimet për pritje ose udhëtim brenda Mbretërisë së Bashkuar duhet të deklarohen. Konferencat në të cilat organizatorët përballojnë shpenzime të arsyeshme për udhëtimin, përjashtohen; në Kanada, deputetëve u kërkohet të raportojnë udhëtimet jashtë vendit të paguara nga agjenci të huaja. Përveç kësaj kërkesë nuk ka kufizime të tjera ose kërkesa deklarimi.

Rregullat dhe instrumentet e deklarimit dhe transparencës së interesave

Rregullat e deklarimit financiar janë mekanizëm i zbatuar përgjithësisht për të ulur sjelljen jo etike të legjislatorëve. Qëllimi është që të zbulohet dhe të bëhet publike pasuria e legjislatorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Publikimi i të dhënave financiare të individit ngre çështjen e të drejtës së jetës private. Mbështetësit e mosdeklarimit të interesave pohojnë se me anë të deklarimit poshtërohet pastërtia e figurës së legjislatorëve dhe mund të frenohet kandidimi i njerëzve të kuaifikuar

Modelet e deklarimit financiar përfshijnë:

➤ Vende të cilat kërkohet deklarim financiar të detyrueshëm.

Vende të cilat aplikojnë këtë lloj regjimi përcaktojnë dhe afatet kohore se kur duhet bërë ky deklarim. Si shembull mund të marrim Gjermaninë ku çdo anëtar duhet të paraqesë deklarim financiar në fillim të mandatit të tij katër vjeçar, por duhet të raportojë çdo të ardhur tjetër, honorar, ose dhuratë gjatë kësaj periudhe; në Çeki dhe Irlandë, deklarimi bëhet vetëm njëherë në vit, pavarësisht momentit të ndryshimit në të ardhurat e deputetit

➤ Vende në të cilat deklarimi i finacave bëhet vullnetarisht – si në rasti i Suedisë

➤ Vende të cilat nuk kanë fare rregulla të deklarimit financiar - si në rastin e Indisë dhe Argjentinën.

Rregullat e deklarimit financiar synojnë të bëjnë të ditur: *pasuritë konkrete, të ardhurat dhe detyrimet*. Vende të ndryshme aplikojnë rregulla specifike mbi atë se çfarë deklarohet: l në Australi, deputetët duhet të deklarojnë çdo pasuri me vlerë mbi 5000 dollarë australianë, përfshirë por jo kufizuar në aksione në shoqëritë publike dhe private, partneritete, detyrime dhe investime; në Japoni, raportohet rroga dhe titulli i çdo posti që mbahet në një shoqëri private, përfshirë postet e papaguara; në Britaninë e Madhe është e detyrueshme të deklarohen të gjitha të ardhurat shtesë, aktivitetet, pronat dhe kuotat në shoqëri të ndryshme.

Shumica e legjislacioneve parashikojnë “pasurinë” e parlamentarëve, si kërkesë për deklarim, ndërkohë të pakta janë ato legjislacione që parashikojnë si kërkesë për raportim “detyrimet”. Parashikimi i rrallë i detyrimit për të deklaruar detyrimet, justifikohet nga fakti se kjo përbën më tepër seç duhet shkelje të një çështje private veçanërisht të ndjeshme. Një ekspert argumenton se përshtimi i detyrimit për të deklaruar pasurinë pa detyrimet jep një panoramë të shtrembëruar të

Lecture notes prepared by E. Olldashi

çështjeve financiare të deklaruesit. Më e rëndësishmja, qënia në borxh, sipas këtij eksperti mund të shpjerë në përplasjen e interesave, madje edhe në korrupsion.⁵

Deklarimi financiar për bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët - Ka vende të cilat kërkojnë si deklarim vetëm pronën që i përket familjes së deputetit (psh në Greqi), ndërkohë në vende të tjera deklarohen edhe përfitime të tjera si dhe dhuratat e dhëna familjes.

Qasja e Publikut në deklaratimet financiare është një nga çështjet më të diskutueshme. Disa vende favorizojnë akses të shtrënguar në regjistrin që përmban të dhëna personale mbi deputetin me qëllimin për të ruajtur të drejtën e privatësisë (psh. Franca dhe Spanja). Të tjera vende favorizojnë aksesin e publikut në këto regjistra, pasi sipas tyre interesi i publikut është primar dhe mbi interes privatë të deputetëve (Angli, Hollandë, Itali).

⁵Carney G, "Conflict of Interests: Legislators, Ministers and Public Officials" (Përplasia e interesave, legjislatorët, ministrat dhe zyrtarët publikë), fq. 7-8.

ANALIZË E LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME ETIKËN DHE KODIN E SJELLJES SË DEPUTETIT

Liria e shprehjes

Gjithashtu Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes së lirë të deputetit duke vënë si kriter të vetëm kufzues “moshpijfen”.⁶ Deputeti kështu vishet me imunitet i cili nënkupton moslogaridhënie për mendimet, opinionet dhe votat e dhëna në ushtrim të funksionit të tij. Kjo mbrojtje nuk i ofrohet në rastin e shpifjes. Moslogaridhënia ose ndryshe papërgjegjshmëria parlamentare përbën njërin nga aspektet e imunitetit për të cilin do të flitet në kapitullin përkatës në vazhdim. Standarte të tjera të parashikuara nga Kushtetuta janë:

- Mos justifikimi i mungesës së deputetit për më shumë se 6 muaj rrjesht në Kuvend.⁷ Standarti që mbrohet është kryerja e detyrës pra paraqitja apo prezenca në të. Kushtetuta parashikon si afat penalizues “afatin 6 mujor”. Në rastin kur kjo periudhe mosshërbimi ndaj publikut kalon 6 muaj, atëherë deputetit i hiqet mandati. Një pjesë e doktrinës është e mendimit se një afat i tillë i cili i korrespondon 1/8 së gjithë mandatit, është tepër i gjatë dhe si rrjedhojë nuk duhet të justifikohet.⁸

- Mos dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.⁹ Kryerja e një krimi mund të ndodhë në dy momente kohore të ndryshme. Rasti i parë hipotetik i kryerjes së krimin është kur ky fakt ndodh gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të deputetit. Rasti i dytë hipotetik është kur krimi është kryer përpara fitimit të mandatit si deputet, por është konstatuar gjatë kohës kur deputeti po e ushtron këtë mandat.

Rregullorja e Kuvendit.

Është një akt i cili gjithashtu përmend çështjet e etikës dhe të sjelljes. KREU IX (neni 62-67) i rregullores i referohet sjelljes së deputetëve në Kuvend ndërkohe nene të tjera të saj përmbajnë rregulla shtesë.

Transparenca përsëritet si standart edhe në Rregulloren e Kuvendit, ku parashikohet se Kuvendi realizon një veprimtari të hapur për Publikun nëpërmjet: pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës, pasqyrimin të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në median e shkruar dhe vizive, botimeve të dokumentacionit parlamentar, faqes zyrtare të Kuvendit, rrjetit të brendshëm audiovizual. Kjo veprimtari gjithashtu pasqyrohet në median e shkruar dhe audiovizive.¹⁰

⁶Neni 73 i Kushtetutës parashikon se: “Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votate dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes”.

⁷Neni 71 pika d e Kushtetutës se Shqipërisë

⁸Methasani E, “Etika dhe Kodi i Sjelljes për përfaqësuesit e popullit. Analizë e legjislacionit në fuqi në RSH dhe nevoja për një kod sjellje, “Studime Juridike” nr 2/2009, fq. 30.

⁹ Neni 71 pika dh e Kushtetutës se Shqipërisë

¹⁰ Neni 105, Rregullorja e Kuvendit.

Lecture notes prepared by E. Olldashi

Rregullorja parashikon edhe sanksione për moszbatimin e rregullave të sjelljes të cilat grupohen në kategori të ndryshme masash disiplinore.¹¹

Masat disiplinore të tërheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes, konsiderohen më të lehta në raport me masat e tjera. Ato jepen nga drejtuesi i seancës plenare kur deputeti thotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin e saj.¹² Masa të rënda ku përfshihet përjashtimi nga seanca plenare jepen kur deputeti përdor fjalë fyese ose cenon personalitetin e drejtuesit të seancës apo vazhdon të kryejë shkeljen, pasi më parë në të njëjtën seancë janë zbatuar masat disiplinore, sipas nenit 64 të kësaj Rregulloreje.¹³ Kur deputeti bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në seancë që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon deputetët e tjerë, anëtarët e Këshillit të Ministrave ose përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës apo institucione të tjeramshtetërore ndalohet të marrë pjesë në punimet e Kuvendit në seancë plenare dhe në komisione deri në 10 ditë. Masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në seancë plenare dhe në komisione shoqërohet me sanksion financiar të mbajtjes së pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore.

Ekzistenca e një Kodi sjelljeje të cilit deputetët duhet ti binden është një detyrim që rrjedh nga Rregullorja e Kuvendit, por ende nuk ka një Kod sjelljeje të miratuar.¹⁴ Miratimi mbetet një detyrim që rrjedh nga një akt normativ si Rregullorja e Kuvendit të RSH, e cila konsiderohet në një rang me Kushtetutën e RSH.

Kodi i Procedurave Administrative.

Ky Kod parashikon se për çdo lloj vendimmarrje, përfshirë vendimrrjen normative të respektohen një sërë parimesh të rëndësishme si: paanshmëria, barazia, ligjshmëria, efënca, reagimi ndaj kërkesave të publikut etj.

Ligji “Për Statusin e Deputetit”

Në këtë ligj, janë parashikuar disa standarte etike për deputetët si më poshtë.

-Respektimi i Kushtetutës dhe i ligjeve dhe ushtrimi i veprimtarisë në përputhje me to.¹⁵ Edhe në këtë ligj papajtueshmëria trajtohet në nga si një çështje me rëndësinë më të madhe etike. Ligji ndjek linjën e parashikimeve kushtetues duke parashikuar se rastet e papajtueshmërisë konsistojnë në:

¹¹Neni 63 i Rregullores së Kuvendit parashikon se: Masat disiplinore që zbatohen ndaj deputetëve janë:

a) tërheqje vëmendjeje; b) vërejtje; c) përjashtim nga seanca plenare; ç) përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare deri në 10 ditë.”

¹²Neni 64 i Rregullores së Kuvendit

¹³Neni 65 i Rregullores së Kuvendit.:

¹⁴ Neni 40(3) i Rregullores së Kuvendit parashikon se nëtarët e Kuvendit, gjatë veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Sjelljes.

¹⁵ Neni 1, i ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Për Statusin e Deputetit” parashikon se: Deputeti vepron në mënyrë të Kushtetutës dhe ligjeve

Lecture notes prepared by E. Oлдashi

a) mosushtrimin njëkohësisht të asnjë detyre shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. b) moskryerja e asnjë veprimtarie fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri prej këtyre. c) mosushtrimi i asnjë veprimtarie shtetërore d) mosqënia drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse¹⁶.

Ky ligj parashikon si standart etik lirinë e shprehjes së deputetëve nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave dhe pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës.¹⁷ Deputeti merr takim periodikisht vetë me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata edhe pse nuk është më i lidhur me mandatin e fituar.¹⁸ Ai i përfaqëson ata duke iu marrë mendime për projektligje, amendamente, vendime dhe materiale të tjera që shqyrton Kuvendi, si dhe mund të marrë pjesë në zbërthimin dhe shpjegimin e tyre. Kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit nëpërmjet deputeti merren në shqyrtim nga organet shtetërore të cilat brenda një muaji nga data e paraqitjes detyrohen të njoftojnë deputetin për mnyrën e trajtimit të tyre.¹⁹

Ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

Synimi i këtij ligji është që të gjithë zyrtarët përfshirë deputetët, të deklarojnë pasuritë e tyre pranë ILDKP, i cili funksionon si institucion i pavarur.²⁰ Në këtë mënyrë ky ligj kontribuon në largimin e dyshimeve të publikut, duke u kërkuar politikanëve të hartojnë në fillim dhe në përfundim të funksionit të tyre një deklaratë të pasurisë së tyre. Deputetët sipas këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë;
- d) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- e) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- f) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- g) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- h) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.

¹⁶ Ligji “Për Statusin e Deputetit” në nenin 3 të tij, referon në nenin 70/2, 70/3, 103 të Kushtetutës për rastet e papajtueshmërisë.

¹⁷ Ligji nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”, neni 4 (3).

¹⁸ Po aty, neni 5.

¹⁹ Po aty, neni 10.

²⁰ Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Lecture notes prepared by E. Oлдashi

- i) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;
- j) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;
- k) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;
- l) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.²¹

Ligji parashikon sanksione në rastet e refuzimit për deklarim. Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. Në këtë rast inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë dhe organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarimin. Kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, Inspektori i Përgjithshëm vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit. Në të gjitha rastet e refuzimit të deklarimit, me kalimin e 30 ditëve nga njoftimi i organit përgjegjës, Inspektori i Përgjithshëm detyrohet t'i bëjë publike rastet e refuzimit të deklarimit.²²

Si rregull deklarimi bëhet në tre raste:

A. Para fillimi të punës

Të gjitha subjektet, që mbartin detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë të gjitha pasuritë e grumbulluara, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë burimet e krijimit të tyre. Subjektet që fillojnë punë për herë të parë detyrohen të deklarojnë edhe angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.²³

B. Pas largimit nga funksioni

Ligji parashikon si detyrim edhe deklarimin pas largimit nga funksioni por ky deklarim do tekryhet vetëm një herë për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarim. Së dyti ky deklarim do të përfshijë vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet

²¹Ligji Nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për Deklarimin Dhe Kontrollin E Pasurive, Të Detyrimeve Financiare Të Të Zgjedhurve Dhe Të Disa Nëpunësve Publikë", neni 3.

²²Po aty, neni 5.

²³Po aty neni 5(2)

Lecture notes prepared by E. Oлдashi

financiare dhe interesat privatë, për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit nga funksioni.

C. Me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm

Inspektori i Përgjithshëm ka detyrimin të kërkojë deklarimin e pasurive e të interesave privatë dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të urdhërojë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarimeve edhe për individët ose personat fizikë e juridikë, kur, nga verifikimet e kryera, rezultojnë se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim periodik.²⁴

Ligji parashikon si kriter për deklarimin e pasurisë dhe interesave private, vënien në dispozicion të një autorizimi të veçantë, ku deklaruesi autorizon organet e përcaktuara në këtë ligj të verifikojnë të gjitha subjektet, private e publike, brenda dhe jashtë vendit, për të dhënat e deklaratës. Duhet theksuar se ligji përfshin si objekt deklarimi pasurisë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur. Persona të lidhur do të konsiderohen rrethi i personave i përcaktuar si i tillë nga pika 11, neni 3 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.²⁵ Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.²⁶

Për kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës, Inspektorati i Lartë ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e nevojshme në të gjithë aparatit shtetëror e publik dhe në personat juridikë publikë e privatë. Me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që, sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklarim.²⁷

Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet: çdo 3 vjet për deputetët. Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjisllacionit në fuqi.²⁸ Të dhënat, që grumbullohen nga deklarimi, sipas këtij ligji, janë të lejueshme për publikun vetëm në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe me ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

²⁴Po aty neni 9.

²⁵Sipas nenit 5 të këtij ligji person i lidhur me një zyrtar është çdo person fizik ose juridik, i cili rezultojnë të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore.

²⁶Po aty, neni 22.

²⁷Po aty, neni 26.

²⁸Po aty, neni 38.

Ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ky ligj ka si qëllim që vendimarrja e funksionarëve publikë, ku përfshihen edhe deputetët të mos ndikohet nga interesa personale.²⁹ Kjo vendimarrje duhet të jetë e paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, ku përfshihet edhe institucioni i rëndësishëm i Kuvendit.

Konflikti i interesit konsiderohet gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.³⁰ Konflikti i interesit mund të jetë:

- a) “*faktik*” - është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij zyrtare;
- b) “*në dukje*” - është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësiive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;
- c) “*mundshëm*” - është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;
- d) “*rast për rast*” - është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimarrje të veçantë;
- e) “*i vazhdueshëm*” - është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dheçose të shpeshtë në të ardhmen. Ky lloj konflikti specifikohet në Seksionin 2, të Kreut III, të po këtij ligji dhe nënukpton se deputeti nuk mundet të ushtrojë veprimtaritë e mëposhtme:

²⁹ Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 5 të tij përcakton rrethin e interesave privatë ose personale, të cilat përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të

ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës ii) të komunitetit; iii) etnike; v) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

³⁰ Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 3.

Lecture notes prepared by E. Olldashi

- nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të njëshoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg. Ky është kptimi që ky nen i jep kuptimit të interesave pasurorë.

-nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fiziktregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, tënoterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit tëorganizatave organizatave fitimprurëse.

- nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;

- nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

Pyetja që deputeti duhet ti bëjë vetes është: “Nëse deputeti do të ishte në pozicionin e një qytetari, në pritje të një vendimi të një zyrtari me të njëjtën kompetencë dhe me të njëjtat interesa si ai vetë, a do të kishte besim ai, në drejtësinë dhe paanësinë e kësaj vendimarrje?”

Ligji parashikon disa kufizime absolute për deputetin lidhur me raste të veçanta, që nuk lidhen me ndonjë vendimarrje të caktuar si më poshtë:

- Ndalimi për lidhjen e kontratave me palë institucionet publike Ky ndalim nuk vlen vetëm për deputetët por edhe për personat e lidhur me to. ³¹Ky parashikim i këtij ligji është në pajtim të plote me Kushtetutën e RSH.

- Ndalimi i dhuratave, favoreve, premtimeve apo trajtimeve preferenciale. cilat i jepen për shkak tëpozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojëlindjen e një konflikti interesi të çdo lloji.³²Ky ndalim nuk vlen vetëm për deputetët por edhe për personat e lidhur me to gjithashtu.³³

Situatat e mësipërme në rast mosrespektimi nga ana e deputetit sjellin pasoja në lidhje me statusin e deputetit, dhe jo për aktin e nxjerrë nga ai³⁴. Kjo mund të nënkuptojë masa si heqje dorë nga angazhimet, funksionet private, mospjesëmarrje në procesin vendimarrës e deri në masa drastike si fillimi i ndjekjes penale. Ndjekja penale do të bëhëtnë përputhje me rregullat në respektim të imunitetit që gëzojnë deputetët.

³¹ Neni 24, i këtij ligji parashikon se: Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 pikat 1, 2 e 6 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, femijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es.

³²Po aty, neni 21-24

³³ Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin në këtë rast zgjerohet, duke përfshirëçdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin endërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim

³⁴Po aty, neni 40.